



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 245, datë 21.12.2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 93, datë 21.05.2021, së z. F. P. F., znj. A. H. B., znj. H. M. V., z. Z. A. P., z. A. H. Z., znj. Z. Q. K., znj. B. N. Ç. dhe z. O. S. P., të përfaqësuar nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Durrës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ndihmës Juridike Falas, të Ministrisë së Drejtësisë, ku pretendohet diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* dhe *“përkatësisë në grup të veçantë”*, nga ana e Bashkisë Durrës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se ankuesit gëzojnë statusin e të verbërit dhe në bazë të vendimeve respektive të KMPV/KMCAP Epror përfitojnë pagesë si persona me aftësi të kufizuar. Pretendimet e ankuesve ndaj Bashkisë Durrës konsistojnë në dy problematika të shtjelluara në formularin e ankesës, të cilat parashtrohen si më poshtë vijojnë:

Së pari, ankuesit pretendojnë se Bashkia Durrës nuk u ka dhënë masën e shtesës së kompensimit për energjinë elektrike në referim të parashikimit të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”*.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në reference të pikës 1, gërma d) të VKM-së së sipërcituar përcaktohet se të verbërit janë përfitues të kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj. Sipas pikës 5, të këtij Vendimi përcaktohet gjithashtu se masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 648 (gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj dhe efekti financiar të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, miratuar për ndihmën ekonomike. Për sa më sipër, ankuesit pretendojnë se nuk e kanë përfituar asnjëherë këtë kompensim.

Pala ankuese sqaron se në shkresën nr. 13773/1, datë 27.11.2020, Bashkia Durrës i ka kthyer përgjigje shoqatës jo fitimprurëse “Shpresë për të verbërit” se bazuar në VKM nr. 404, datë 20.06.2012 *“Për përcaktimin e masës, të kritereve dhe procedurave të përfitimit dhe kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbërit dhe invalidit para dhe tetraplegjik”* kategoria e të verbërve rimburohet në vlerën prej 2.000 lekë për të verbërit e grupit të parë dhe në vlerën 1.400 lekë për të verbërit e grupit të dytë, ndërkohë që nuk përmendet masa e shtesës për kompensim të energjinë elektrike sipas VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”*.

Së dyti, ankuesit pretendojnë për mosmarrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transportin qytetas të kësaj kategorie, si dhe mosmarrjen e asnjë mase nga ana e këtij institucioni ndaj ofruesve të shërbimeve të transportit urban për mosnjohjen e statusit të verbërisë. Në këtë kontekst, pala ankuese pretendon se Bashkia Durrës nuk ka vepruar në përmbushje të detyrimeve të caktuara ligjore dhe kategoria e personave të verbër nuk përfitojnë lehtësi në transportin urban qytetas. Kjo problematikë sipas palës ankuese është shfaqur që prej muajit korrik 2020 e në vijim.

Në këtë kontekst, pala ankuese vë në dukje faktin se kjo problematikë është e ndeshur edhe në bashki të tjera të vendit. Lidhur me sa më sipër, pala ankuese vë në vëmendje të Komisionerit, vendimmarrje të tjera të tij, sikurse është rasti i vendimit nr. 67, datë 10.06.2019, ku është konstatuar diskriminimi, si pasojë e mosmarrjes së masave nga ana e organeve të qeverisjes vendore ndaj operatorëve të shërbimit urban, që nuk kanë ofruar lehtësi në shërbimin urban qytetas për kategoritë vulnerabël.

Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Durrës thekson se në bazë të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*, i ndryshuar, transporti qytetas është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore. Njëkohësisht në ankesë sqarohet se kuadri ligjor ekzistues dhe specifikisht neni 11, i ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 *“Për statusin e të verbërit”*, të ndryshuar u jep të drejtë kategorisë së të verbërve që të përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Sipas parashikimit të këtij neni masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, akt ky që ende nuk është miratuar.

Për sa më sipër, pala ankuese kërkon nga ana e KMD-së konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të veçantë, marrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport të kategorisë së të verbërve, si dhe të merren masa nga ana e këtij institucioni për të siguruar pagesën për shtesën mbi kompensimin e energjisë elektrike, sipas Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësisë në grup të veçantë”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A. Pas analizimit të ankesës nr. 93, datë 21.05.2021, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B. Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Durrës, me shkresën nr. 774/1, datë 22.05.2021, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
 - Informacion i përgjithshëm mbi pretendimet e grupit të ankuesve;
 - Informacion mbi procedurat që duhen ndjekur nga personat me aftësi të kufizuara dhe specifikisht për ata që gëzojnë statusin e personit të verbër në bazë të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “*Për statusin e të verbërit*”, të ndryshuar, për të marrë kompensim financiar në bazë të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për*

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

- Të kryhen verifikimet përkatëse dhe të dërgohet informacion nëse secili prej ankuesve e përfiton masën e shtesës së kompensimit për energjinë elektrike në referim të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”*, duke specifikuar edhe momentin, nga i cili kanë filluar të jenë përfitues.
 - Informacion nëse secili prej ankuesve ka bërë kërkesë me shkrim ose ankesë pranë strukturave përkatëse të Bashkisë Durrës, lidhur me këtë çështje. Nëse po, të dërgohet kopje e kërkesës/ankesës dhe përgjigjes zyrtare të Bashkisë Durrës;
 - Informacion mbi lehtësitë që përfitojnë personat që gëzojnë statusin e të verbërit në transportin urban qytetas në qytetin e Durrësit;
 - Cilat janë udhëzimet e dhëna (me shkrim) nga Bashkia Durrës për operatorët e shërbimit urban qytetas, me të cilët ka lidhur kontratë shërbimi, për sa i përket ofrimit të lehtësive për personat me aftësi të kufizuar dhe specifikisht për personat e verbër, deri në miratimin e VKM-së që do të përcaktojë masën, kriteret dhe procedurat e kompensimit që ata duhet të përfitojnë ligjërisht. Të dërgohen kopje të kontratave të shërbimit me këta operatorë;
 - A ka marrë Bashkia Durrës, udhëzime zyrtare nga Ministria përgjegjëse, lidhur me ofrimin e lehtësive ndaj kategorisë së individëve me aftësi të kufizuar, në shërbimin urban qytetas deri në miratimin e VKM së sipërcituar?
- Në përgjigje të shkresës nr. 774/1, datë 22.05.2021, së KMD-së, Bashkia Durrës dërgoi shkresat nr. 6421/2, datë 15.06.2021 dhe nr. 6421/2, datë 16.06.2021, nëpërmjet së cilave kundërshton pretendimin e grupit të ankuesve, për diskriminim për shkaqet e cituara më sipër, si pasojë e mosdhënies së masës për shtesën e kompensimit për energjinë elektrike. Bashkia Durrës thekson faktin se asnjë nga ankuesit nuk ka paraqitur kërkesë me dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të ligjore, për të përfituar kompensimin e energjisë elektrike, sikurse parashikohet në aktet nënligjore.

Në shkresën nr. 6421/2, datë 15.06.2021, e Bashkisë Durrës theksohet fakti se në pikën 3, të Udhëzimit nr. 1, datë 02.02.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri*

në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike” ka përcaktuar se: “Të verbërit, paralegjikët dhe tetraplegjikët së bashku me deklaratën sipas Aneksit nr. 1 duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror: a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit, b) fotokopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose fotokopjen e vendimit të KMCAP/KMPV; c) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara”.

Nëpërmjet shkresës nr. 6421/2, datë 16.06.2021, Bashkia Durrës vë në dukje faktin se nga verifikimet e kryera, asnjë prej ankuesve nuk ka kërkuar dhe nuk ka marrë kompensim për energjinë elektrike të parashikuar sipas VKM-së nr. 8, datë 14.01.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”.

Njëkohësisht, ky institucion sqaron se personat me aftësi të kufizuar udhëtojnë falas në linjat urbane të këtij qyteti. Ndërkohë që, linjat interurbane janë kompetencë e Ministrisë përgjegjëse.

- Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr. 774/4, datë 07.07.2021, të KMD-së, palët u njoftuan për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 21.07.2021, ora 10:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë përfaqësuesja e Qendrës së Ndihmës Juridike Parësore (QNJP) Durrës. Bashkia Durrës nuk u përfaqësua në seancë dëgjimore, ndaj kjo seancë u zhvillua pa praninë e këtij institucioni. Përfaqësuesja e QNJP Durrës parashitroi edhe një herë pretendimet e parashtruara në ankesë. Lidhur me pretendimin e parë, përfaqësuesit e KMD-së i kërkuar informacion, nëse ankuesi kishin depozituar kërkesë me shkrim dhe dokumentacionin e kërkuar nga aktet nënligjore, për të përfituar kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj. Përfaqësuesja e QNJP Durrës sqaroi se ankuesit janë paraqitur fizikisht pranë Bashkisë Durrës, por nuk kanë bërë kërkesa me shkrim. Përfaqësuesit e KMD-së i kërkuar informacion vijues edhe në lidhje me çështjen e transportit qytetas Durrës, si dhe e njohën me përgjigjen zyrtare të dërguar nga Bashkia Durrës, lidhur me të dy pretendimet e ngritura në ankesë.

- Në vijim të seancës dëgjimore, KMD i dërgoi Bashkisë Durrës shkresën nr. 774/5, datë 22.09.2021, nëpërmjet së cilës i kërkoj të depozitonte në cilësi prove pranë KMD-së, çdo akt administrativ të nxjerrë nga ky institucion, që vërtetonte së shërbimi urban qytetas u ofrohej falas personave me aftësi të kufizuar, ku përfshiheshin edhe kategoria e personave të verbër.
- Bashkia Durrës dërgoi me e-mail, në datën 04.10.2021, kontratën e shërbimit operatorin e shërbimit urban qytetas në Durrës.

- Për të marrë informacion më të plotë rreth çështjes së transportit urban për kategorinë e personave të verbër, KMD iu drejtua nëpërmjet shkresës nr. 1616 prot., datë 23.11.2021, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, Dega Durrës dhe për dijeni Bashkisë Durrës dhe Qendrës së Ndhmës Juridike Parësore Durrës. Në këtë shkresë, KMD kërkoi informacion mbi mënyrën se si sigurohet transporti urban për kategorinë e të verbërve në qytetin e Durrësit, si dhe çdo fakt dhe prove, që këto shoqata dispononin lidhur me këtë çështje. Nëpërmjet kësaj shkrese u kërkua nga shoqatat, që informacioni i kërkuar të dërgohej brenda 5 (pesë) ditësh nga marrja dijeni.
- Në kushtet kur, shoqatat e sipërcituara nuk dërguan asnjë informacion, lidhur me çështjen në fjalë brenda afatit të caktuar, përfaqësuesit e KMD-së kontaktuan me telefon me përfaqësues të tyre, duke u kërkuar të dërgonin informacionin përkatës.
- Në përgjigje të shkresës nr. 1616 prot., datë 23.11.2021, së KMD-së, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dërgoi shkresën nr. 120, datë 01.02.2021, nëpërmjet së cilës sqaron se pas hapjes graduale që u bë në vijim të pandemisë Covid-19 u shfaq problematika e mosofrimit të shërbimit urban falas për disa muaj në qytetin e Durrësit.

Sipas shkresës në fjalë, rezulton se pas marrjes së disa ankesave nga qytetarë të verbër që përdornin transportin urban pranë kësaj bashkie, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë dhe dega e saj në Durrës iu drejtuan zyrtarisht Bashkisë Durrës për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ky institucion ktheu përgjigje zyrtare se transporti urban është parashikuar të jetë falas në kontratat, që ka lidhur me kompanitë që ushtrojnë këtë aktivitet në territorin e Bashkisë Durrës.

Në vijim, që nga muaji tetor 2020, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë thekson faktin se nuk ka marrë më ankesa nga qytetarët e verbër, lidhur me çështjen e shërbimit urban qytetas. Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë vë në dukje faktin se aktualisht, të gjithë qytetarët e verbër që përdorin këtë shërbim duke treguar Librezën e Verbërisë, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror e përfitojnë falas këtë shërbim.

- Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, Dega Durrës nuk i dërgoi përgjigje shkresës së Komisionerit.

C. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesve.

1.1.Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesve, si pasojë e mospërfitimit të shtesës së kompensimit për energjinë elektrike deri në 300 Kwh në muaj.

Pretendimi i parë i ankuesve të përfaqësuar nga Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Durrës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ndhmës Juridike Falas, të Ministrisë së Drejtësisë, konsiston në faktin se Bashkia Durrës nuk u ka dhënë masën e shtesës së kompensimit për energjinë elektrike në referim të parashikimit të Vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj”*.

Në referencë të pikës 1, gërma d) të VKM-së së sipërcituar përcaktohet se të verbërit janë përfitues të kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për efekt të heqjes së fashës së konsumit deri në 300 Kwh në muaj.

Sipas pikës 5, të këtij Vendimi përcaktohet gjithashtu se masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 648 (gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë në muaj dhe efekti financiar të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, miratuar për ndihmën ekonomike.

Në zbatim të VKM-së së sipërcituar, është miratuar Udhëzimi nr. 1, datë 02.02.2015, i Këshillit të Ministrave, *“Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike.”* Në pikat 3 dhe 4, të Udhëzimit të sipërcituar, është përcaktuar shprehimisht se: *“Të verbërit, paralegjikët dhe tetraplegjikët së bashku me deklaratën sipas Aneksit nr. 1 duhet të paraqesin pranë administratorit shoqëror: a) fotokopje të nënshkruar të kartës së identitetit, b) fotokopje të librezës së lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose fotokopjen e vendimit të KMCAP/KMPV; c) fotokopje të librezës së energjisë elektrike që vërteton se nuk ka detyrime të papaguara”*. 4. Lista e hartuar nga administratori shoqëror miratohet nga Këshilli i Njësisë së Qeverisjes Vendore.”.

Për sa më sipër, pas verifikimeve të kryera nga Bashkia Durrës rezulton se ankuesit nuk kanë aplikuar dhe nuk kanë përcjellë dokumentacionin e kërkuar sipas Udhëzimit të sipërcituar pranë administratorit shoqëror dhe lista e tyre nuk është miratuar nga Këshilli i Njesisë së Qeverisjes Vendore. Akti nënligjor i sipërcituar parashikon detyrimin e tyre të kryejnë procedurat përkatëse, për të qenë përfitues të shtesës së kompensimit për energjinë elektrike.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se ankuesit nuk janë ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë nga ana e Bashkisë Durrës. Në mungesë të një qendrimi të tillë nuk ka diskriminim për shkaqet e pretenduara.

Për sa më sipër, KMD i sugjeron ankuesit të ndjekin procedurat e parashikuara në Udhëzimin nr. 1, datë 02.02.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Mbi zbatimin e vendimit nr. 8, datë 14.01.2015, të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga heqja e fashës deri në 300 Kwh për faturimin e çmimit të energjisë elektrike”*, si dhe të depozitojnë dokumentacionin e kërkuar pranë autoriteteve përgjegjëse, për të qenë përfitues të shtesës së kompensimit për energjinë elektrike.

1.2.Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesve, për mosofrimin e lehtësive për shërbimin urban qytetas.

Ankuesit pretendojnë gjithashtu për mosmarrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transportin qytetas të kësaj kategorie, si dhe mosmarrjen e asnjë mase nga ana e këtij institucioni ndaj ofruesve të shërbimeve të transportit urban për mosnjohjen e statusit të verbërisë.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 13-14 të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”*,⁴ i ndryshuar, transporti qytetas është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 85, i ligjit të sipërcituar parashikon:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

⁴ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 37/2014 *“Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 21/2013, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”*).

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Për sa më sipër, dispozita e sipërcituar e ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, ka vendosur detyrimin dhe ka autorizuar nxjerrjen e një akti nënligjor nga e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Ky akt nënligjor nuk rezulton të jetë miratuar.

Para vitit 2012, neni 11, i ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar, parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat.*” Pas ndryshimit të pësuar në vitin 2012 të ligjit të sipërcituar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.3.2012, neni 11 i tij parashikon se: “*Të verbërit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*”

Në kushtet kur, VKM-ja e cituar në nenin 85, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, nuk është miratuar ende nga Këshilli i Ministrave, Bashkia Durrës e ofron falas shërbimin urban qytetas, për të gjithë kategorinë e të verbërve.

Gjatë korrespondencës zyrtare me KMD, Bashkia Durrës ka dërguar kontratën e lidhur me operatorët e shërbimit urban. Në nenin 23, gërma b), “*Transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve*”, të kontratës së shërbimit⁵, të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe operatorit të shërbimit urban qytetas, parashikohet shprehimisht se:

“*b. Udhëtimin falas të kategorive të mëposhtëme që zotërojnë librezën përkatëse të lëshuar nga organet kompetente:*

- i. invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre;*
- ii. vetëranët e luftës;*
- iii. të verbërit dhe shoqëruesit e tyre;*
- iv. invalidët e punës;*

⁵Referuar kontratës së shërbimit Nr. 1146 Prot., datë 01.07.2019, të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe shoqërisë Maren Bus shpk.

- v. *personat me aftësi të kufizuara;*
- vi. *jetimët, në kushtet e legjislacionit në fuqi.”*

Një fakt i tillë mbështetet si gjatë korrespondencës zyrtare me Bashkinë Durrës, ashtu edhe nëpërmjet shkresës nr. 120, datë 01.02.2021, së Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë.

Pala ankuese ka sqaruar se problematika lidhur me shërbimin urban rezulton të ketë qenë evidente nga muaji korrik 2020 e në vijim. Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ka sqaruar se kjo problematikë lidhet me kushtet kur, vendi ynë sapo filloi të lehtësonte masat shtrënguese të marra si pasojë e pandemisë Covid-19. Ndërkohë që, nga muaji tetor 2020 e në vijim situata është stabilizuar dhe shërbimi urban qytetas ofrohet falas, duke treguar Librezën e Verbërisë, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror. Në këtë kontekst, KMD gjykon se pas shfaqjes së kësaj problematike, Bashkia Durrës ka marrë masat përkatëse ndaj operatorit urban, me qëllim ofrimin e shërbimit urban falas.

Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Durrës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ndhmës Juridike Falas, të Ministrisë së Drejtësisë u bë me dije lidhur me sa më sipër. Pasi kreu verifikimet përkatëse, kjo Qendër dërgoi e-mail në datën 17.12.2021, në adresë të KMD-së, duke kërkuar tërheqjen e ankesës, lidhur me pretendimin e dytë, pasi qëllimi, për të cilin ishte depozituar ankesa është arritur.

Në këto kushte, Komisioneri gjykoj se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* (i ndryshuar), ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa. Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*⁶, Komisioneri deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 94/1, e ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1,

⁶ Neni 94/1, i ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikon: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të së z. F. P. F., znj. A. H. B., znj. H. M. V., z. Z. A. P., z. A. H. Z., znj. Z. Q. K., znj. B. N. Ç. dhe z. O. S. P., të përfaqësuar nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Durrës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ndihmës Juridike Falas, të Ministrisë së Drejtësisë, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* dhe *“përkatësisë në grup të veçantë”*, nga ana e Bashkisë Durrës, lidhur me pretendimin për mospërfitim të shtesës për energjinë elektrike.
2. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrative, lidhur me pretendimin e mosmarrjes së masave nga ana e Bashkisë Durrës, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transportin qytetas të kësaj kategorie, si dhe mosmarrjen e asnjë mase nga ana e këtij institucioni ndaj ofruesve të shërbimeve të transportit urban për mosnjohjen e statusit të verbërisë, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkak – aftësia e kufizuar
Fusha – të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit – mosdiskriminim dhe arritje efektiviteti